

20151925281

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR AKADEMINË PËR**  
**GJYKATËS DHE PROKURORË PUBLIKË**

Neni 1

Në Ligjin për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 20/15), pas nenit 9 shtohen tre tituj të ri dhe tre nene të reja: 9-a, 9-b dhe 9-v, si vijojnë:

**"Mbrojtje elektronike gjatë zbatimit të provimeve**

Neni 9-a

(1) Gjatë zbatimit të provimeve që jepen me anë elektronike, në përputhje me këtë ligj, personi i autorizuar teknik i cili e realizon provimin është i obliguar që ta bllokojë shtrirjen e radio frekuencës në hapësirën për dhënien e provimit gjatë zbatimit të sesioneve të provimeve.

(2) Agjencia për Komunikime Elektronike (në tekstin e mëtejme: AKE) bën monitorim të vazhdueshëm të bllokimit të shtrirjes së radio frekuencave në hapësirën për dhënien e provimit, me qëllim që të parandalojë çfarëdo lloji të komunikimit elektronik me rrethin jashtë hapësirës për dhënien e provimit.

(3) AKE, në hapësirën për dhënien e provimit instalon pajisje matëse e cila siguron regjistrim elektronik të matjeve të realizuara në kohëzgjatje prej 30 ditësh, dhe të njëjtat magazinohen në sistemin kontrollues qendror të AKE.

(4) AKE formon komision tre anëtarësh i cili përpilon raport në bazë të regjistrimeve elektronike të magazinuara në sistemin kontrollues qendror të AKE dhe të njëjtin e dërgon në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë më së voni në afat prej 15 ditësh prej përfundimit të sesionit të provimeve.

(5) Gjobë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlerë në denarë do të kumtohet për personin e autorizuar juridik i cili teknikisht i realizon provimet nga paragrafët 21, 64 dhe 97 të këtij ligji, në rast se nuk e bllokoi shtrirjen e radio frekuencës në hapësirën për dhënien e provimit.

**Komisioni për revizionin e provimeve të mbajtura**

Neni 9-b

(1) Këshilli Drejtues i Akademisë formon Komision për revizionin e provimeve të realizuara që jepen me anë elektronike në përputhje me këtë ligj, i cili në punën e vet i shfrytëzon materialet nga neni 31, paragrafi (2) i këtij ligji dhe ku marrin pjesë edhe përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni takohet pas çdo provimi të mbajtur dhe bën revizion të realizimit të provimeve, përfshirë këtu edhe nëse provimin e kanë dhënë kandidatë të cilët nuk i përmbushin kushtet për dhënien e provimit në përputhje me paragrafët 20 dhe 57 të këtij ligji, për çka dorëzon raport te Këshilli Drejtues i Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë.

(3) Anëtarëve të Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni u takon kompensim me para, që në nivel vjetor është një pagë mesatare neto në Republikën e Maqedonisë, për çka merr Aktvendim Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë.

(4) Me gjobë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë në denarë do të dënohen anëtarët e komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni, në rast se konstatojnë parregullsi gjatë zbatimit të provimeve, ndërsa këtë nuk e konstatojnë në raportin për Këshillin Drejtues të Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë.

### **Zbatimi i dispozitave për dhënien elektronike të provimit për drejtor, gjatë dhënies së provimit pranues dhe përfundimtar**

#### Neni 9-v

Gjatë dhënies së provimit pranues dhe përfundimtar, zbatohen dispozitat e këtij ligji për mënyrën e dhënies së provimit për drejtor me anë elektronike.”

#### Neni 2

Në nenin 14 fjalët: "përveç anëtarëve sipas funksionit" shlyhen.

#### Neni 3

Neni 19 ndryshohet si vijon:

"(1) Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë kompensimi për punën e bërë, si edhe të drejtë kompensimi për harxhime ditore dhe të udhëtimit, në përputhje me rregullat me të cilat rregullohen ato çështje.

(2) Kompensimi për punën e bërë nga paragrafi 1 i këtij neni është dhjetëmijë denarë në muaj."

#### Neni 4

Në nenin 22 në paragrafin (3), fjala "njëherë" zëvendësohet me fjalën "dyherë".

Në paragrafin (5), pas fjalës "vendos", shtohen fjalët: "më së paku 30% të", ndërsa pas fjalës "mënjahohen" shtohen fjalët: "dhe zëvendësohen me të reja".

Paragrafi (8) ndryshohet si vijon:

"Kompensimi vjetor në para nga paragrafi (6) i këtij neni nuk e tejkalon nivelin e pagës mujore të një gjykatësi në Gjykatën e Apelit".

#### Neni 5

Në nenin 23, pas fjalës "Akademia", shtohen fjalët: "për çka Këshilli Drejtues i Akademisë përcakton person përgjegjës i cili përcakton nëse kandidati i përmbush kushtet për dhënien e provimit."

Pas paragrafit (1), shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3) si vijojnë:

"(2) Me gjobë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë në denarë do të dënohet personi nga paragrafi (1) i cili do të lejojë që të hyjë në provim kandidati i cili nuk i përmbush kushtet e përcaktuar me këtë ligj.

(3) Personit përgjegjës nga paragrafi (1) i këtij neni, për çdo sesion të mbajtur të provimit i takon kompensim në para, në shumë prej një të tretat e pagës mesatare neto në Republikën e Maqedonisë, për çka Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë miraton aktvendim."

#### Neni 6

Në nenin 24 pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2), si vijon:

"(2) Kandidatët të cilëve u aprovohet kërkesa për dhënien e provimit dhe publiku informohen për datën dhe kohën e dhënies së provimit më së paku tetë ditë para mbajtjes së provimit përmes ueb faqes së Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë dhe përmes Servisit Publik të Radiodifuzionit."

Paragrafët (2) dhe (3) bëhen paragrafë (3) dhe (4).

Pas paragrafit (4) i cili bëhet paragraf (5) shtohet paragraf i ri (6), si vijon:

"(6) Përfaqësuesve nga paragrafi (5) i këtij neni, për çdo sesion të mbajtur të provimit u takon kompensim në para, në shumë prej një të tretat e pagës mesatare neto në Republikën e Maqedonisë, për çka Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë miraton aktvendim."

#### Neni 7

Në nenin 25 në paragrafin (7), pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët "dhe i kumtohet ndalesë për dhënien e provimit për drejtor në kohëzgjatje prej te vitesh, për çka Këshilli Drejtues i Akademisë merr Aktvendim kundër të cilit mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të aktvendimit."

Pas paragrafit (9), shtohen dy paragrafë të rinj (10) dhe (11) si vijojnë:

"(10) Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'u kumtohet përfaqësuesve të autorizuar nga neni 24, paragrafi (5) i këtij ligji, nëse lejojnë që kandidati të veprojë në kundërshtim me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

(11) Gjobë në shumë prej 100 deri në 200 euro në kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet kandidatit që vepron në kundërshtim me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni."

#### Neni 8

Në nenin 31 paragrafët (3) dhe (4) shlyhen.

#### Neni 9

Në nenin 38, pas paragrafit (2), shtohen tre paragrafë të rinj (3), (4) dhe (5) si vijojnë:

(3) Zgjedhja e një anëtari dhe një zëvendësi të tij nga radhët e profesorëve të rregullt ose inordinerë të shkencave juridike ose juristëve të shquar me titull akademik doktor shkencash me më së paku gjashtë vite përvojë pune në fushën e drejtësisë, bëhet me anë të thirrjes publike që e zbaton Këshilli Drejtues i Akademisë.

(4) Anëtarët e Këshillit Programor kanë të drejtë kompensimi për punën e bërë, si edhe të drejtë kompensimi për harxhime ditore dhe të udhëtimit, në përputhje me rregullat me të cilat rregullohen ato çështje.

(5) Kompensimi për punën e bërë nga paragrafi (4) i këtij neni është pesëmijë denarë në muaj."

#### Neni 10

Në nenin 72 në paragrafin (3), fjala "njëherë" zëvendësohet me fjalën "dyherë", ndërsa pas fjalës "në vit", shtohen fjalët: "me ç'rast së paku 30% të bazës së pyetjeve zëvendësohen me pyetje të reja,".

#### Neni 11

Neni 81 ndryshohet si vijon:

"Gjatë dhënies së pjesës praktike (me shkrim) të provimit, lejohet shfrytëzimi i ligjeve (pa komente dhe sqarime), që në versionin elektronik gjenden në kompjuterin në të cilin kandidati e jep pjesën praktike (me shkrim) të provimit."

#### Neni 12

Neni 104 ndryshohet si vijon:

"Gjatë dhënies së pjesës praktike (me shkrim) të provimit përfundimtar, lejohet shfrytëzimi i ligjeve (pa komente dhe sqarime), që në versionin elektronik gjenden në kompjuterin në të cilin kandidati e jep pjesën praktike (me shkrim) të provimit."

Neni 13

Neni 119 ndryshohet si vijon:

"Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligj bën Ministria e Drejtësisë, përveç për dispozitat kundërvajtjese të këtij ligji për të cilat mbikëqyrje bën Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë."

Neni 14

Pas nenit 119, shtohet titull i ri dhe nen i ri 119-a si vijon:

**"Matja e lartësisë së gjobës të personit juridik**

Neni 119-a

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik bëhet në përputhje me Ligjin për kundërvajtje."

Neni 15

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurën e kundërvajtjes do ta udhëheqë dhe sanksion kundërvajtës do të kumtojë gjykata kompetente.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.